

VENDIM
Nr. 77, datë 6.2.2026

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2026, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
EDI RAMA

Lidhja nr. 1

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2026

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	7	MF	Paraqet në KM kuadrin makroekonomik e fiskal 2026–2028
Janar	14	KM	Miraton kuadrin makroekonomik e fiskal 2026–2028
Janar	16	SASPAC/KM/KPS	Përgatit dhe diskuton projektdokumentin e politikave prioritare 2027–2029
Janar	19	SASPAC	Paraqet projektdokumentin e politikave prioritare 2027–2029 për miratim në KM
Janar	26	KM	Miraton dokumentin e politikave prioritare 2027–2029
Shkurt	18	MF	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2027–2029, për fazën strategjike
Shkurt	27	MF	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore
Mars	6	KM	Paraqet për informacion në Kuvend kuadrin makroekonomik e fiskal 2027–2029
Mars–prill	3 mars–28 prill	Njësitë e qeverisjes qendrore	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	29 prill–30 prill	Njësitë e qeverisjes qendrore	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2027–2029
Maj	1	Njësitë e qeverisjes qendrore	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	4–15 maj	MF	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	4–15 maj	SASPAC/KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioritetëve të politikave 2027–2029
Maj	18–29 maj	MF	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Maj	1–2 qershor	MF/SASPAC	Prezanton dokumentin e PBA 2027–2029 me shoqërinë civile
Qershor	2	MF	Paraqet në KM kuadrin makroekonomik e fiskal të rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i>
Qershor	10	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i>

			<i>se shihet e nevojshme)</i>
Qershor	17	MF	Përgatit dokumentin e PBA 2027–2029 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2027–2029
Qershor	17	SASPAC/KM/KPS	Përgatit dokumentin e rishikuar të politikave prioritare 2027–2029 (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	22	MF	Paraqet dokumentin e PBA 2027–2029 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2027–2029, për shqyrtim dhe miratim në KM
Qershor	25	KM	Miraton dokumentin e PBA 2027–2029 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2027–2029
Qershor	22	SASPAC	Paraqet dokumentin e rishikuar të politikave prioritare 2027–2029 për miratim në KM (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	25	KM	Miraton dokumentin e politikave prioritare të rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Korrik	3	MF	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2027–2029
Korrik	10	MF	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në fazën teknike, në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
Korrik–gusht	10 korrik–31 gusht	Njësitë e qeverisjes qendrore	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shtator	1	Njësitë e qeverisjes qendrore	Paraqesin në MFE kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	2–11	MF	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	2–11	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2027–2029.
Shtator	14–25	MF	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Tetor	28 shtator–9 tetor	MF	Përgatit projektbuxhetin e vitit 2027 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2027–2029 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.
Tetor	15	KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2027, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2027–2029
Tetor	20	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2027–2029, të miratuar nga KM-ja
Tetor	20	KM	I paraqet Kuvendit projektbuxhetin e vitit 2027